



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

VLERËSIMI I POLITIKËS PAS ZBATIMIT

NDIKIMI I REGJIMIT TË TAKSAVE NË KATËR SEKTORË PRODHUES

(Metali, Tekstili, Druri dhe Përpunimi i ushqimit)

Prishtinë, 2014



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

VLERËSIMI I POLITIKËS PAS ZBATIMIT

NDIKIMI I REGJIMIT TË TAKSAVE NË KATËR SEKTORË PRODHUES

(METALI, TEKSTILI, DRURI DHE PËRPUNIMI I USHQIMIT)

Prishtinë, 2014

MIRËNJOHJE

Financimi është siguruar nga Ministria për Punë të Jashtme e Finlandës, në suaza të projektit “Ndihmë Tregtisë”.

Raporti pregaditur nga:

AGON MALIQI – Autorë

DREN POZHEGU - Autorë

KONTRIBUT I VEÇANT DHËNË NGA:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

Kabineti i Ministrit

Departamenti i Industrisë

Vlerësimi i Kualitetit, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë:

TEUTA PURRINI XHABALI, Menaxhere e Projektit, projekti “Ndihmë Tregtisë”

ANITA SMAILOVIC, Bashkëpunëto e Projektit, projekti “Ndihmë Tregtisë”

ERBLIN RIBARI, NUNV Zyrtar Projekti, projekti “Ndihmë Tregtisë”

ARTANE RIZVANOLLI – Konsulente e Jashtme

ERËBLINA ELEZAJ, Analiste për Hulumtim, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim

BURBUQE DOBRANJA, Bashkëpunëto e Informim Publik, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim

DANIJELA MITIĆ, Analiste për Komunikim, Ekipi për Hulumtime dhe Politika, Çështje Gjinore dhe Komunikim

Përkthyes:

ARIANA KICA

Një mirënjohje e veçantë u takon të gjitha bizneseve të intervistuar dhe akterëve të tjerë relevant.

Ky dokument nuk ka të drejtë autoriale prandaj përmbajtja e tij mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht pa lejen paraprake të UNDP-së. Mirëpo, burimi i saj, duhet të citohet.

Analiza dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe të Ministrisë për Punë të Jashtme të Finlandës.

PËRMBAJTJA

1. HYRJA: SYNIMI DHE FUSHËVEPRIMI I KËRKIMIT	5
2. SHQYRTIM KONCEPTUAL	5
3. PASQYRA E TRENDEVE NË REGJIMIN E TAKSAVE NË KOSOVË	8
4. PASQYRA E TRENDEVE NË SEKTORËT E PRODHIMIT: TË METALIT, DRURIT, TEKSTILIT DHE PËRPUNIMIT TË USHQIMIT	10
5. ANALIZA E PROBLEMIT: TAKSAT DHE NDIKIMI I TYRE NË KATËR SEKTORËT E PRODHIMIT	15
<i>5.1. Vlerësimi i ndikimit të përqindjes së taksave</i>	<i>15</i>
<i>5.2. Vlerësimi i ndikimit të administratës tatimore</i>	<i>22</i>
6. PËRKUFIZIM I PROBLEMIT: ILUSTRIM GRAFIK	27
7. KONKLUZË: IMPLIKIMET POLITIKE	28

LISTA E SHKURTESAVE

ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
CEE	Evropa Qendrore Lindore
BE	Bashkimi Evropian
IHD	Investimet e Huaja Direkte
FYROM	ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
DK	Dogana e Kosovës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës
MF	Ministria e Financave e Kosovës
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
NVM	Administrata Tatimore e Kosovës
ATK	Analiza e Rrezikut dhe Kontrolli i Pikave Kritike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
TVSH	Tatimi i Vlerës së Shtuar
BP	Ballkani Perëndimor

1. HYRJA: SYNIMI DHE FUSHËVEPRIMI I KËRKIMIT

Synimi i këtij vlerësimi të politikës është të analizohet efekti i regjimit tatimor në sektorin prodhues të Kosovës¹ gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Më konkretisht, duke u fokusuar në një grup të industrive prodhuese, të cilat konsiderohen me rëndësi strategjike nga autoritetet e Kosovës, ky studim do të përqijet në radhë të parë të përcaktojë - në bazë të të dhënave empirike në dispozicion - nëse regjimi i taksave që ka funksionuar gjatë dy viteve të fundit ka pasur një efekt negativ, neutral ose pozitiv në zhvillimin e sektorit të prodhimit.

Pasi që Kosova nuk ka aftësinë për të zbatuar një politikë monetare, politika fiskale – të hyrat dhe shpenzimet e qeverisë – mbetet instrument i vetëm në duart e saj për të nxitur zhvillimin industrial. Gjatë dy viteve të fundit, shkalla e lartë e shpenzimeve publike (p.sh. investimet në infrastrukturë, subvencione, skemat e granteve, etj) kanë stimuluar ekonominë nëpërmjet rritjes së kërkesës agregate, duke përmirësuar kështu fondin e infrastrukturës fizike. Megjithatë, në ekonominë e tregut, investimet e sektorit privat janë ato që luajnë rol kyç për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Shkalla e tyre varet, ndër të tjera, nga ekzistimi i një klime të favorshme dhe konkurruese të biznesit që zvogëlon koston e të bërit biznes.

Edhe pse në këtë klimë të biznesit luajnë rol shumë faktorë – duke filluar nga sundimi i ligjit, aftësitë e forcës së punës, përqindjet e kamatave, dhe deri te ekzistimi i infrastrukturës cilësore publike – një rol të rëndësishëm luajnë edhe stimujt fiskalë, që do të thotë spektri i përqindjes së taksave dhe masave simulative, të cilat duhet të synojnë që njëkohësisht të arrijnë dy synime: të sigurojnë stabilitetin buxhetor dhe makroekonomik duke mos përfaqësuar barrë për aktivitetin e biznesit dhe zhvillimin ekonomik.

Studimi synon të vlerësojë në mënyrë retroaktive ndikimin e përqindjes së taksave të zbatueshme në Kosovë dhe administrimin e sistemit tatimor në klimën e investimeve për sektorin e prodhimit. Kjo bëhet duke shikuar treguesit e disponueshëm nga burime të ndryshme, siç janë të dhënat primare nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat e Kosovës, hulumtimet me biznese, burime të tjera ndihmëse dhe intervistat me palët e interesuara.

Duhet theksuar se ekziston një vështirësi e madhe në izolimin e ndikimit të taksave mbi rezultatet siç janë investimet apo klima e përgjithshme e biznesit në sektorët e veçantë të prodhimit. Kjo ndodh për shkak se këto të fundit janë ndikuar nga faktorë të panumërt, ndonjëherë madje edhe të pakapshëm ose të pamatshëm, siç janë normat kulturore. Ka, pra, kufizime të konsiderueshme në studimin dhe aftësinë e tij për të arritur përfundime vendimtare. Megjithatë, mund të arrihen disa përfundime dhe interpretime të përgjithshme, të cilat shpresojmë se do t'i shtojnë vlerën debeteve të ardhshme të politikave për zhvillimin e sektorit të prodhimit në Kosovë.


2. SHQYRTIMI KONCEPTUAL

Konceptualisht, ideja se taksat e ulëta dhe stimujt fiskalë mund të ndihmojnë në zhvillimin e sektorit privat buron veçanërisht nga ekonomia neo-klasike. Ajo sugjeron se taksat e ulëta lejojnë bizneset të mbajnë më shumë të ardhura për vete dhe në këtë mënyrë të investojnë në zgjerimin dhe konkurrencën e tyre. Dëshmitë nga e gjithë bota tregojnë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë reciproke midis përqindjeve tatimore dhe vështirësive në të bërit biznes. Për shembull, duke u

¹ Për UNDP, të gjitha referencat e Kosovës në këtë dokument janë në Kontekst të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999).

bazuar në të dhënat nga Raporti Botëror i Forumeve Ekonomike të Konkurrencës Globale 2014 – i cili konsideron përqindjet e taksave si një tregues të konkurrencës – revista *The Economist* raporton (shih Figurën 1 më poshtë) një korrelacion të moderuar pozitiv midis përqindjeve të larta tatimore të korporatave dhe bizneseve që thonë se përqindjet e taksave janë barrë për operacionet e tyre në mbarë botën.

Figura 1: Korrelacioni mes përqindjeve tatimore dhe perceptimi i taksave si pengesë për biznes



Burimi: *The Economist*, 2014

Ekziston një mungesë e hulumtimit mbi ndikimin e përqindjeve tatimore në investimet e sektorit privat dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë, në sektorin e prodhimit, etj. Kjo nuk është për t'u habitur. Mbi të gjitha, mungesa e të dhënave të qëndrueshme, të detajuara dhe të besueshme në Kosovë ka vështirësuar çdo përpjekje të tillë madje e ka bërë edhe të pamundur. Kosova sapo ka kaluar nëpër një proces të ndërtimit të institucioneve dhe tek tani ka filluar të grumbullojë të dhënat tatimore ose sondazhet e ndërmarrjeve që mund të përdoren për të ndërtuar seri më të gjata kohore dhe për të analizuar trendet. Së dyti, duke pasur parasysh se Kosova është në tranzicion nga një ekonomi socialiste e centralizuar në një ekonomi kapitaliste të tregut; me një dekadë të ekzistimit si shtet paralel joefektiv; një konflikt shkatërrues në mes të tranzicionit; dhe një gjysmë-dekadë administrim të bashkësisë ndërkombëtare, shqetësimi kryesor i të cilës janë të drejtat e njeriut, nuk është për t'u habitur se politikat tatimore dhe efekti i tyre nuk kanë qenë prioritet për studiuesit.

Meqenëse ka mungesë të provave nga Kosova lidhur me ndikimin e politikave tatimore në sektorin e prodhimit, një alternativë do të ishte të konsultohet literatura mbi Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Lindore në përgjithësi. Meqenëse rajoni ka kaluar nëpër sfida të ngjashme tranzicioni dhe qeverisjeje – edhe pse më pak problematike – literatura mbi ndikimin e taksave në sektorin e prodhimit është në mënyrë të ngjashme e kufizuar. Prandaj, jemi përqëndruar në dimensione të tjera – të tilla si studimet që fokusohen në përcaktuesit e Investimeve të Huaja Direkte, të cilat mund të konsiderohen si zëvendësim për qëllimet e këtij studimi.

Pjesa më e madhe e hulumtimit mbi përcaktuesit e Investimeve të Huaja Direkte ka tendencë të përqëndrohet në cilësinë institucionale, përbërjen strukturore të ekonomisë, koston e forcës punëtore dhe burokracinë shtetërore si faktorë të brendshëm, dhe faktorët e jashtëm siç janë afërsia gjeografike me tregjet e mëdha, anëtarësimi në BE apo marrëveshje me BE-në, si faktorë më relevantë për joshjen e investimeve të huaja direkte dhe zhvillimit ekonomik. Përqindjet e taksave nuk paraqiten në listën e lartë të faktorëve vendimtarë për investimet e huaja direkte. Në shumicën e rasteve ato dalin ose statistikisht të parëndësishme ose kanë efekt më të ulët se faktorët tjerë.

Në kuadër të Shërbimeve Këshillimore të Grupit të Bankës Botërore për Klimën e Investimeve, Xhejms thotë se, edhe pse është debatuar gjerësisht dhe nuk është arritur konsensus i qartë, stimulimi i investimeve siç është ulja e taksave, kanë një efekt të kufizuar në investim dhe se një klimë e favorshme investimi duhet të jetë prioritet për qeveritë². Xhejms vazhdon të argumentojë se edhe pse zbritja e përqindjes së taksave ndihmon në nxitjen e Investimeve të Huaja Direkte, efekti i një klime të mirë të investimeve mund të jetë tetë herë më i fortë.

Në mënyrë të ngjashme, në një studim të veçantë për atraktivitetin e Ballkanit Perëndimor për IHD, Matija Rojec dhe Slavica Penev argumentojnë se pesë përparësitë e shteteve të Ballkanit Perëndimor janë ambienti i qëndrueshëm makro-ekonomik, sistemi financiar relativisht i zhvilluar, zhvillimi i shpejtë ekonomik, kostoja relativisht e ulët e punës së kualifikuar, si dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE-në dhe Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA)³. Dobësitë përfshijnë tregjet e vogla vendase dhe fuqinë e ulët blerëse të popullsisë, rrezikun e lartë, përparimin e ngadalshëm në reformat strukturore dhe institucionale, burokracinë joefikase të qeverisë dhe barrierat e larta administrative. Në bazë të këtij hulumtimi, ata argumentojnë se prioriteti kryesor i joshjes të numrit më të madh të IHD-ve është forcimi i reformës strukturore dhe institucionale, kurse disa politika të veçanta të IHD-së duhet të kenë prioritet më të ulët.

Ngjashëm me Rojec dhe Penev, Saul Estrin dhe Milica Uvalic⁴ argumentojnë se faktorët e modelit të gravitetit ndikojnë në fluksin e investimeve të huaja direkte në Ballkan. Megjithatë, në analizën e tyre faktori "Ballkani Perëndimor" vërteton ndikimin negativ në fluksin e IHD-ve. Kjo tregon se historia më e re politike dhe rreziqet politike ndikojë negativisht në investimet e huaja direkte. Ata argumentojnë se është i nevojshëm zhvillimi dhe reforma e mëtejshme institucionale dhe se njoftimet dhe synimet për bashkim me BE-në, kanë ndikim pozitiv në investimet e huaja direkte.

2 Stimujt dhe investimet tatimore dhe jotatimore: Provat dhe Implikimet Politike. Sebastian James. Dhjetor 2009.

3 Atraktiviteti i vendeve të Ballkanit Perëndimor për IHD. MatijaRojec dhe SlavicaPenev. 2011.

4 Investimet e huaja direkte në ekonomitë në tranzicion: a është Ballkani ndryshe?. Saul Estrin dhe MilicaUvalic. 2013

Një rezultat i ngjashëm është gjetur nga Ines Kersan-Skabiq dhe Edvard Orliç⁵ të cilët kanë studiuar përcaktuesit e fluksit të IHD-ve në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Ballkanin Perëndimor. Ata konstatojnë se përqindjet e taksave janë një përcaktues statistikisht i rëndësishëm i fluksit të IHD-ve në Evropën Qendrore dhe Lindore, mirëpo janë të parëndësishëm për Ballkanin Perëndimor. Kjo do të thotë se në Ballkanin Perëndimor ka kufizime të tjera relativisht të forta dhe se taksat do të bëhen faktor shumë i rëndësishëm me përparimin e vendeve në tranzicion dhe do të arrijnë nivel të lartë të zhvillimit ekonomik dhe institucional.

Një studim nga Xhafiq dhe të tjerët analizon në mënyrë të përpiktë një gamë të gjerë të faktorëve që pengojnë zhvillimin e NVM-ve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ata argumentojnë se këta faktorë janë pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve: burokracia, kohëzgjatja e zbatimit të gjykimeve ligjore, dhënia e lejeve të ndërtimit, korrupsioni, mungesa e stimulimit financiar / mbështetja e qeverisë për zhvillimin e ndërmarrjeve prodhuese, intervali kohor në mes të datës së caktuar të gjykimit dhe dhënies së vendimit, mungesa e masave të qeverisë për të nxitur punësimin, cilësia e fuqisë punëtore, cilësia e rrjeteve rrugore, pagesat e sigurimeve sociale dhe shëndetësore, regjistrimi i pasurive të patundshme, si dhe cilësia dhe kostot e telekomunikacionit. Përqindjet e taksave nuk hyjnë në këtë listë.

Vildan Serin dhe Ahmet Çallëshkan⁶ përdorin një model që mundohet të lidhë politikat ekonomike të liberalizimit dhe investimet e huaja direkte. Ata konstatojnë se një treg më i madh, një mjedis më i qëndrueshëm politik, një barrë më e vogël fiskale, një vëllim më i madh tregtar, një mjedis më i lirë i biznesit, shpjen drejt fluksit më të madh të investimeve të huaja direkte. Një pjesë e mjedisit më të lirë të biznesit është lëvizshmëria e lirisë fiskale, e cila mat barrën fiskale dhe e cila është dëshmuar si një variabël e rëndësishme shpjeguese. Nga të gjitha studimet e shqyrtuara⁷, Serin dhe Çallëshkan janë të vetmit që fokusohen bindshëm mbi lirinë fiskale.

3. PASQYRA E TRENDEVE NË REGJIMIN E TAKSAVE NË KOSOVË

Qëllimi i vlerësimit të kësaj politike është të hedhë dritë mbi mënyrat me të cilat regjimi i taksave në Kosovë ka ndikuar katër sektorët e prodhimit gjatë dekadës së fundit (metalit, drurit, tekstilit dhe përpunimit të ushqimit). Një analizë e tillë historike nuk mund të bëhet pa e kuptuar kontekstin e politikës dhe shtjellimin e historisë dhe trendeve në të dy variablet përkatëse: të regjimit të taksave dhe të aktivitetit ekonomik në sektorët e përmendur më sipër.

Historia e sistemit tatimor të Kosovës në një ekonomi të lirë të tregut është në të vërtetë mjaft e re. Gjatë viteve 1990, roli i shtetit të centralizuar në ekonomi dobësohej. Shteti formal ishte diskriminues ndaj qytetarëve të vet dhe i mungonte legjitimiteti, ndërsa një shtet paralel funksiononte me një legjitimitet më të lartë, por me efikasitet shumë të ulët në terren. Dy "shtetet" ushtronin autoritetin e tyre tatimor, por tregu lulëzoi në joformalitet. Prandaj, sistemi i taksave ishte ose i paefektshëm për shkak të paligjshmërisë së shtetit formal ose punonte në

5 Përcaktuesit e fluksit të IHD në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Vendet e Ballkanit Perëndimor (A është anëtarësimi në BE i rëndësishëm për joshjen e IHD?). Ines Kersan-Skabic dhe Edvard Orlic. 2007.

6 Politikat e Liberalizimit Ekonomik dhe Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore. Vildan Serin dhe Ahmet Çaliskan. 2010.

7 Studime të tjera të shqyrtuara por që nuk janë përmendur në pjesën e literaturës së konsultuar: A posedojnë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore përparësi për IHD në krahasim me vendet më të zhvilluara perëndimore? Miroslav Mateev dhe Ilya Tsekov. 2012. Situata Aktuale dhe Perspektivat e Investimeve të Huaja Direkte në rajonin e Ballkanit. Arjan Qefalia dhe Pleurat Rexhepi. 2009. Përcaktuesit e Tregtisë së Kosovës: Qasja e Modelit të Gravitetit. Florin Peci, Mario Holzner, dhe Enver Kutllovci. 2010. Klima e Biznesit si një nga përcaktuesit kryesorë të investimeve të huaja direkte në jug. Ylldeze Sokoli, Lavdosh Zaho dhe Ina Sokoli. 2011. Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rrezikut në IHD. Studim hulumtues në Ballkan. Nicos Sykianakis. 2007. Trashëgimia historike dhe Investimet e Huaja Direkte në Bosnjë e Hercegovinë. Joel I. Deichmann. 2012.

bazë vullnetare për shtetin paralel - dhe ky boshllëk është shfrytëzuar edhe nga sektori joformal i sapo formuar privat.

Pasi administrata e UNMIK-ut mori kontrollin e Kosovës, në nëntor të vitit 1999 u krijua një Autoritet Qendror Fiskal. Ky institucion punonte në kuadër të UNMIK-ut dhe ishte përgjegjës për sistemin e përgjithshëm financiar në Kosovë - mbledhjen e taksave, hartimin e buxhetit të Kosovës, hartimin e politikës fiskale⁸. Disa muaj më parë në vitin e njejtë, u formua Dogana e Kosovës, e cila ka qenë përgjegjëse për vendosjen e tatimit të importit prej 10%, akcizave dhe taksën e shitjes prej 15%⁹. Taksa e shitjes është aplikuar në pikat kufitare për produktet e importit, meqenëse administrata tatimore nuk ekzistonte gjatë asaj kohe e madje edhe më vonë kur u formua, i mungonte aftësia për të ushtruar në mënyrë efektive autoritetin e vet. Edhe pse taksa e shitjes më vonë do të ndryshonte në Tatimin e Vlerës së Shtuar, Dogana e Kosovës vazhdoi të mbledhte taksat e importit, akcizën dhe tatimin e vlerës së shtuar në pikat kufitare, për arsye praktike, meqenëse grumbullimi i buxhetit ishte i varur nga importet, kurse kapacitetet për të mbledhur taksat brenda vendit ishin të dobëta.

Autoriteti Qendror Fiskal vazhdoi punën e vet si institucion i vetëm mbi temën e çështjeve fiskale deri sa u krijua Departamenti për Ekonomi dhe Financa. Pasi që kapacitetet e Departamentit të Ekonomisë dhe Financave u forcuan – dhe më vonë ky departament do të shndërrohej në një ministri – atëherë edhe puna brenda departamentit gjithashtu ishte e ndarë. Për këtë arsye, Administrata Tatimore e Kosovës është formuar me përgjegjësinë e vetme të mbledhjes së taksave, duke aplikuar ligjet e taksave dhe duke dhënë sqarime në lidhje me pagesat e taksave.

Kështu u vunë bazat e sistemit fiskal. U shtuan edhe taksa të reja – të tilla si tatimi i hoteleve, shërbimeve të ushqimit dhe pijeve, si dhe tatimi i pronës. Struktura e taksave më vonë azhurnohej dhe u miratuan ligjet e reja për të krijuar një kornizë ligjore për zbatimin e tyre. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) do të zëvendësonte taksën e shitjes në maj të vitit 2001. Taksa e re TVSH kishte përqindjen e njëjtë me taksën e mëparshme të shitjes: 15%¹⁰. Ligji mbi të ardhurat personale u miratua në vitin 2002, i cili aplikoi përqindjen prej 0% të taksave për të ardhurat vjetore deri në 600 euro, 10% për të ardhurat prej 600 euro deri në 3.000 euro, dhe 20% për të ardhurat më të larta se 3,000 euro plus një normë të caktuar prej 240 euro¹¹. Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave është miratuar në vitin 2004 dhe aplikon një normë prej 20%¹².

Gjatë kësaj kohe – nga viti 1999 deri më sot – struktura dhe legjislacioni tatimor janë ndryshuar shpesh¹³. Megjithatë, shumë nga këto ndryshime nuk janë të mëdha. Përqindjet e taksave në përgjithësi mbetën të njëjta gjatë viteve. Viti i vetëm kur u paraqitën ndryshime të rëndësishme ishte viti 2009, kur taksat në të ardhurat e korporatave u zvogëluan nga 20 në 10%. Tatimi mbi të

8 UNMIK Rregullore Nr. 1999/16. Për themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal të Kosovës dhe çështje të lidhura me të.

9 UNMIK, Rregullore Nr. 1999/3. Për themelimin e Doganës dhe të shërbimeve të tjera përkatëse në Kosovë.

10 UNMIK, Rregullore Nr. 2001/11. Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

11 UNMIK, Rregullore Nr. 2002/4. Për Tatimin mbi të Ardhurat personale.

12 UNMIK, Rregullore Nr. 2004/51. Për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave.

13 Para së gjithash, taksat janë zbatuar dhe zëvendësuar dhe pastaj janë shfuqizuar plotësisht, siç janë Taksa e Shitjes e cila u miratua në vitin 1999, u azhurnua në vitin 2000 dhe më vonë u shfuqizua në vitin 2001. Në mënyrë të ngjashme, Tatimi i Presupozuar dhe Tatimi mbi Fitim u nxorrën si ligje të veçanta, siç ishin Rregullativa nr. 2000/29 për tatimin e presupozuar në vitin 2000 dhe Rregullativa nr. 2002/3 për Tatimin mbi Fitim në vitin 2002. Më vonë këto ligje u azhurnuan me ligje të tjera, pastaj u shfuqizuan ose u përfshinë në ligje të tjera. Përveç ndryshimeve në strukturën e taksave, ndryshimet janë bërë edhe në legjislacionin tatimor. Për shembull, qysh nga aplikimi i parë në vitin 1999 si pjesë e Doganës së Kosovës, ligji mbi taksën e akcizës u miratua në vitin 2000, dhe gjatë vitit të njejtë u ndryshua tre herë. Deri në vitin 2014, ligji i akcizave ka ndryshuar 18 herë. Ngjashëm, taksa e importit që u zbatua për herë të parë në vitin 1999, u ndryshua 12 herë. Ligji për Tatimin e Vlerës së Shtuar u miratua për herë të parë në vitin 2001, dhe prej atij viti u ndryshua 7 herë.

ardhurat personale u zvogëlua nga një taksë progresive që varion nga 0-20% tatim me gjithsej tre grupe të përqindjeve tatimore, në një taksë progresive që varionte prej 0-10% me katër grupime, kurse tatimi mbi vlerën e shtuar u rrit nga 15% në 16%.

Sa u përket taksave të importit: kur ligji u miratua për herë të parë në vitin 1999, të vetmet mallra që mund të hynin në Kosovë pa pasur nevojë të paguajnë taksat e importit ishin mallrat që do të përdoren nga organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë dhe nga misionet diplomatike, të tilla si UNMIK, ambasadat, Kryqi i Kuq dhe të gjitha agjencitë e OKB-së, si dhe artikujt e domosdoshëm jetik si ushqimi (frutat, perimet, qumështi) dhe produktet farmaceutike.

Aktualisht, sistemi tatimor në Kosovë është relativisht i thjeshtë. Ai përfshin një taksë të përbashkët prej 10%, një taksë progresive në të ardhurat personale prej 0-10%, tarifatat doganore në 10%, vlera e tatimit të shtuar prej 16%, dhe taksat e akcizës. Përveç stimuljeve themelore tatimore – shkarkimi nga taksat e importit dhe shkarkimi nga TVSH për disa mallra dhe shërbime të caktuara – ligjet nuk kanë paraparë stimul të madh tatimor. Në vitin 2013, Ministria e Financave dekretoi një Udhëzim Administrativ për zbatimin e "TVSH të pandryshueshëm" për bujqit. Ky tatim i pandryshueshëm i Vlerës së Shtuar u mundëson bujqve që t'i shesin prodhimet e veta në firmat agro-përpunuese pa u regjistruar si firma zyrtarisht, në mënyrë që firmat e agro-përpunimit të mund të blejnë produktet e tyre në mënyrë të ligjshme dhe të mos paguajnë TVSH për bujqit. Kjo masë ofron një zgjidhje për bujqit e vegjël, sidomos ata që ndodhen në mes të bujqësisë për mbijetesë dhe bujqësisë komerciale dhe që nuk kanë mundësi të regjistrojnë firmat zyrtarisht për të shitur 'ligjërisht' produktet e tyre.

Megjithatë, zhvillimet e fundit që kanë të bëjnë me zonat e lira ekonomike paraprijnë ndryshime në stimujt e taksave. Komuna e Gjakovës dhe Mitrovicës janë shpallur zona të lira ekonomike nga autoritetet e Kosovës në mars të vitit 2014¹⁴. Edhe pse mbetet e paqartë se cilët stimuj ekonomik do t'i gëzojnë zonat e lira ekonomike, institucionet e Kosovës tashmë kanë vendosur shkarkim nga taksat për bizneset që investojnë një shumë të caktuar dhe do të punësojnë një numër të caktuar të njerëzve¹⁵. Mirëpo, këto vendime ende nuk janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës; prandaj nuk është e qartë nëse dhe kur do të zbatohen.

4. PASQYRA E TRENDEVE NË KATËR SEKTORËT E PRODHIMIT: TË METALIT, DRURIT, TEKSTILIT DHE PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Para se të vlerësohet ndikimi i regjimit të taksave në sektorët e prodhimit, është me rëndësi që së pari të kuptohen disa fakte themelore për këta sektorë dhe të ilustruhet udhëpërshkrimi i tyre gjatë dekadës së fundit – pra, nëse kanë treguar shenja të rritjes apo rënies. Kjo do të ndihmojë që të kontekstualizohet analiza dhe treguesit që janë përdorur për të shpjeguar lidhjen shkakësore mes taksave dhe aktivitetit ekonomik në këta sektorë.

Këta katër sektorë janë sektorët më të mëdhenj të prodhimit për sa i përket aktivitetit ekonomik, eksportit, krijimit të punësimit dhe një varg tregues të tjerë. Një pasqyrë më e plotë e sektorëve – duke përfshirë informatat themelore të firmave, strukturën e hyrjeve dhe daljeve, tregjet, burimet njerëzore, etj - ofrohet në profilet e sektorit që janë krijuar me anë të Projektit Ndihmë për Tregtinë nga UNDP dhe MTI.¹⁶

14 Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 03/178 dhe 02/178.

15 Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 07/186

16 Profilet sektoriale: <http://www.invest-ks.org/en/sectoral-studies>


Një nga vlerat më të mëdha të këtij dokumenti është fakti se jep një pasqyrë empirike për performancën e sektorëve gjatë tetë viteve të fundit. Është vlerësuar rrugëtimi i sektorëve duke analizuar të dhënat e importit dhe eksportit nga baza e të dhënave e Doganës së Kosovës për periudhën 2005-2013. Nga kjo e fundit, vlera e importit dhe eksportit për mallërat e sektorëve është marrë veç e veç për çdo sektor dhe për çdo vit në periudhën 2005-2013 (Figurat 3, 4, 5 dhe 6).¹⁷ Janë nxjerrë përpjestimet e importit dhe eksportit për secilin sektor, me idenë që të rritet vlera e mallrave të eksportuara nga firmat vendase, kurse zvogëlimi gradual i raportit mes importit dhe eksportit do të jetë tregues për rritjen e sektorit të brendshëm.

Këtu duhet të theksohet se të dhënat e importit dhe eksportit nuk janë treguesi më i mirë i aktivitetit, sidomos kur krahasojmë një sektor me një tjetër, pasi që disa sektorë janë më të orientuar drejt eksportit dhe ndonjë mund të dështojë në rritjen e shitjeve në tregun e brendshëm. Mirëpo, në mungesë të burimeve të tjera empirike me linja të këtylla reale të trendeve, të dhënat e importit dhe eksportit mund të konsiderohen si shifra stabile, sidomos kur paraqiten si raport në mes të dyjave, meqenëse reduktimet në import do të pasqyronin zëvendësimin e importit.

Figura 2 më poshtë ilustron raportin e vlerave të importit dhe eksportit për të katër sektorët në periudhën 2005-2013. Kjo tregon se të katër sektorët vendas të prodhimit filluan periudhën me deficite jashtëzakonisht të larta tregtare të sektorit (raportet mes importit dhe eksportit) të cilat janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës. Raporti mes importit dhe eksportit ka shënuar rënie për sektorin metalik (15 deri 2), sektorin e tekstilit (125 në 29), sektorin e drurit (99 në 19) dhe përpunimin e ushqimit (35 në 16). Kjo është për shkak se përqindja mesatare vjetore e rritjes së eksporteve ka tejkaluar dukshëm përqindjen vjetore të rritjes së importit për të gjithë sektorët (shih Tabelën 1). Kështu, të dhënat sugjerojnë se këta sektorë vendas të prodhimit kanë qenë në gjendje të eksportojnë më shumë dhe/ose të zëvendësojnë importin me kalimin e kohës, gjë që nënkupton zgjerimin e sektorëve gjatë viteve. Megjithatë, duhet theksuar se ata kanë filluar nga një bazë shumë e ulët – domethënë, në terme monetare rritja në shumicën e rasteve ishte e vogël.

17 *Shënim metodologjik:* Sektorët janë përcaktuar duke bërë grupimin e mallrave në pajtim me kodet relevante HS 2002. Për këtë qëllim, **sektori i përpunimit të ushqimit** është definuar se përbëhet nga produktet në vijim: mishi; sheqeri dhe prodhimet e sheqerit; kakao dhe produktet e kakaos; drithërat, mielli, niseshte e qumështit; produktet e pastiçerisë; perimet, frutat, frutat arrore ose pjesë të tjera të bimëve; preparate të ndryshme të ngrënëshme; pijet, alkoolet dhe uthulla; mbetjet dhe mbeturinat nga industritë e ushqimit; ushqimi i përgatitur për kafshët; duhani. **Sektori i përpunimit të drurit** përfshin: artikujt e drurit; tapë dhe artikujt të drurit dhe mobiljet e drurit. **Sektori i tekstilit** përbëhet nga: artikujt e veshmbathjes dhe aksesuarët e veshjes, që nuk janë të thurura ose të bëra me grep; artikujt të tjerë tekstili; këpucë; kapela. **Sektori i përpunimit të metalit** përbëhet nga hekuri dhe çeliku; artikujt e hekurit dhe çelikut; bakri dhe artikujt e tij, plumbi dhe artikujt e tij; zinku dhe artikujt e tij; kallaji dhe artikujt e kallajit; metale të tjera bazë – metaloqeramike dhe artikujt e tyre; mjete; të ndryshme; mobilje metalike; metale të çmuara për bizhuteri.

Figura 2: Raporti mes importit dhe eksportit për katër sektorët (2005-2013)



Burimi: Dogana e Kosovës.


Tabela 1: Ndryshimet e % mesatare vjetore për importin dhe eksportin në katër sektorët (mesatarja gjeometrike).

Sektori	Ndryshimi i % mesatare vjetore (Import)	Ndryshimi i % mesatare vjetore (eksport)
Metalit	13.4%	42.8%
Drurit	9.3%	34.5%
Ushqimit	8.9%	19.8%
Tekstilit	10.8%	32.7%

Burimi: Dogana e Kosovës.

Tani do të përqëndrohemi për çdo sektor në veçanti, për të krijuar pasqyrë mbi vlerat monetare dhe zhvillimin brenda sektorëve. Të dhënat tregojnë se në sektorin e përpunimit të ushqimit (Figura 3) vlera e mallrave të eksportuara është rritur nga 4.5 milionë euro në vitin 2005 në 19 milionë në vitin 2013. Ndërsa kërkesa e brendshme për import është rritur me një mesatare prej 8.9% në vit, kërkesa për eksport është rritur me një mesatare prej 19.8% në vit. Siç ilustron Figura 2, kjo ka zvogëluar raportin mes importit dhe eksportit nga 35 në 16.


Figura 3: Përpunimi i ushqimit: Importi dhe Eksporti (2005-2013) në milion euro



Burimi: Dogana e Kosovës.

Sektori i drurit ndjek një model pak më të ndryshëm nga tendenca e përgjithshme (Figura 4). Lakorja e eksportit arrin kulminacion në vitin 2007, duke treguar rritje nga 0.7 milion euro në 3.3 milionë euro, mirëpo prej atëherë është ulatur, duke arritur një vlerë pak më të vogël prej 3.1 milionë euro në vitin 2013. Mirëpo, raporti mes importit dhe eksportit është zvogëluar dukshëm pasi përqindja mesatare e rritjes vjetore ka tejkaluar përqindjen e rritjes së importit.


Figura 4: Përpunimi i drurit: Importi dhe Eksporti (2005-2013) në milion euro



Burimi: Dogana e Kosovës.

Sektori i tekstilit (Figura 5) ka treguar përmirësimin më të madh në bilancin tregtar të gjithë sektorëve, duke zvogëluar raportin mes importit dhe eksportit nga 125 në 29. Mirëpo, përmirësimi është i freskët dhe është parë në katër vitet e fundit (2010-2013) kur raporti bëri një zhytje të pjerrtë. Gjatë kësaj periudhe eksporti u rrit nga 0.5 milion euro në vitin 2010 deri në 2.7 milionë euro në vitin 2013, kurse importi shënoi rënie ose stagnim pas rritjes së vazhdueshme në periudhën paraprake.


Figura 5: Tekstili: Importi dhe Eksporti (2005-2013) në milion euro



Burimi: Dogana e Kosovës.

Sektori i metalit mund të konsiderohet sektori më i mirë në drejtim të bilancit tregtar. Vlerat e eksportit janë rritur në mënyrë dramatike (nga 6 milionë euro në vitin 2005 deri në 107 milionë euro në vitin 2013) si rezultat i fillimit të operacioneve nga një gjigand industrial (Ferronikeli) edhe pse me luhatje të larta, ndërsa lakorja e importit ndjek një trajektore të qëndrueshme në rritje. Paqëndrueshmëria e eksportit kryesisht mund t'i atribuohet ndryshimit në kërkesat e tregut global dhe çmimeve për produkte të tilla si ferronikeli.

Figura 6: Përpunimi i drurit: Importi dhe Eksporti (2005-2013) në milion euro



Burimi: Dogana e Kosovës.

5. ANALIZA E PROBLEMIT: TAKSAT DHE NDIKIMI I TYRE NË SEKTORËT E PRODHIMIT

Çfarë sugjerojnë të dhënat e importit dhe eksportit përveç se theksojnë se këta sektorë të prodhimit janë zhvilluar gjatë viteve? Ajo që është më me rëndësi për qëllimet e këtij studimi, i cili synon të identifikojë ndikimin kauzal të një variable (taksat), është se zhvillimi nënkupton që mjedisi ka qenë i favorshëm që ajo të ndodhë, edhe pse kjo nuk e përjashton mundësinë që zhvillimi të ketë qenë më i madh pa i penguar shkaqet. Mjedisi i përshtatshëm influencohet nga një sërë faktorësh dhe vështirë është të konstatohet vetëm nga këto të dhëna roli i veçantë i taksave në krahasim me variablat e tjerë. Nuk ekziston asnjë shenjë e dukshme në aktivitetin e asnjë sektori që mund të sugjerojë ndikimin nga zvogëlimi i përqindjes së taksave (në vitin 2009).

Në mënyrë të ngjashme, mungesa e burimeve të detajuara institucionale dhe/ose burimeve të tjera dytësore e bën të pamundur zhvillimin e një metodologjie të shëndoshë shkencore e cila do të zbulonte të gjitha variablat relevante dhe do të izolonte çdo ndikim të rëndësishëm statistikor të taksave. Megjithatë, ekzistojnë disa tregues të kufizuar që mund të shërbejnë si përfaqësues dhe të cilët, kur analizohen së bashku si pjesë e një enigme, mund të japin një shpjegim të arsyeshëm mbi ndikimin që taksat mund të kenë pasur në sektorin e prodhimit. Prandaj, ne kemi provuar të gjejmë përgjigje të mundshme duke vlerësuar barrën që shkaktohet nga **përqindjet e taksave** dhe **administrata tatimore** (me një fokus të veçantë në çështjet që kanë të bëjnë me **joformalitetin** dhe **zbatimin**). Për këtë qëllim kemi përdorur si burime dhe tregues, si vijon:

- a) Qëndrimin krahasues rajonal dhe global të Kosovës lidhur me përqindjet e taksave dhe administratën tatimore;
- b) Treguesit sasiorë që pasqyrojnë qëndrimin e firmave lidhur me përqindjet dhe administrimin e taksave, të nxjerrë nga sondazhet e ndërmarrjeve;
- c) Të dhënat cilësore nga intervistat me ata që njohin sfidat e firmave prodhuese në Kosovë;
- d) Tendencat e mbledhjes së taksave nga baza e të dhënave e Administratës Tatimore të Kosovës;
- e) Burimet dytësore dhe studimet e realizuara nga hulumtues të tjerë.

5.1 Vlerësimi i ndikimit të përqindjes së taksave

Një mënyrë potenciale për të vlerësuar shkallën në të cilën përqindja e taksave mund të ketë përfaqësuar barrë për prodhuesit kosovarë, është që këto përqindje të krahasohen me ato të vendeve të tjera të rajonit dhe botës, sidomos ato vende ose blloqe ekonomike që janë partnerë kryesorë tregtarë të Kosovës. Prandaj, mund të konsiderohet se përqindjet më të vogla të taksave luajnë rol pozitiv pasi që do të nënkuptojnë se firmat kosovare kanë pasur kosto më të ulëta dhe kështu shkallë më të lartë të konkurrencës në krahasim me konkurrentët e tyre rajonalë dhe globalë.

Kosova ka qenë dhe është në fakt mjaft konkurruese në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian (BE 27), pasi përqindjet e saj të tatimeve i përkasin nivelit më të ulët të gamës rajonale. Një krahasim i detajuar i përqindjeve tatimore është paraqitur në Tabelën 2, e cila përfshin informatat për tri lloje të taksave: taksat e korporatave, tatimi mbi të ardhurat

personale dhe tatimi i vlerës së shtuar (TVSH). Në rastin e TVSH-së, gjithashtu është mbledhur dhe krahasuar pragu minimal i qarkullimit vjetor përpara se një firmë të jetë e detyruar të regjistrohet për TVSH.

Duhet të theksohet se të dhënat në Tabelën 2 paraqesin një tablo të përgjithshme të përqindjes së taksave në rajon dhe në BE 27; megjithatë, nuk marrin parasysh politikat e veçanta tatimore apo stimuj të tillë si heqjet e përkohshme të taksave, uljet e taksave për sektorë të caktuar ekonomikë, apo heqjen e përkohshme të taksave për kompanitë që punësojnë apo që investojnë në hulumtim dhe zhvillim. Për më tepër, informatat e prezantuara janë përqindje të taksave nominale të cilat mund të mos zbatohen domosdoshmërisht në mënyrë të barabartë për të gjitha firmat. Përqindja mesatare e tatimit mund të ndryshojë varësisht nga politikat tatimore, siç u përmend më sipër, dhe vendi ku është e vendosur firma. Duke pasur parasysh se shumë vende kanë zona të lira ekonomike që nuk aplikojnë asnjë taksë, përqindjet mesatare efektive të taksave janë me siguri të ndryshme nga përqindjet e taksave nominale.

Përqindja e taksës së korporatave nuk ndryshon shumë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Mesatarisht, taksë e korporatave në Ballkanin Perëndimor qëndron e pandryshueshme në rreth 10% – si në Kosovë. Serbia dhe Shqipëria ndryshojnë pak me një përqindje të fiksuar tatimore prej 15% dhe një përqindje progresive që fillon prej 2% e deri në 15%. Përfundimisht në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është Kroacia, tani anëtare e Bashkimit Evropian, e cila aplikon taksën e korporatave prej 20% (pak më të ulët se mesatarja në BE27 prej 22.75%).

Tatimi mbi të Ardhurat Personale ndikon në koston e fuqisë punëtore. Sa më e lartë është përqindja e taksës aq më të ulëta janë të ardhurat neto për fuqinë punëtore dhe më të larta janë shpenzimet për bizneset. Duke pasur parasysh këtë marrëdhënie, niveli i tatimit mbi të ardhurat personale luan rol në përcaktimin e aftësisë konkurruese. Me një taksë progresive që fillon nga 0% në maksimum 10%, Kosova aplikon tatimin më të ulët mbi të ardhurat personale në rajon. Shumica e vendeve të tjera krahasohen me Kosovën për faktin se kanë taksë prej 10%, mirëpo ndërsa për Kosovën tatimi prej 10% është përqindja maksimale e detyrueshme, vendet e tjera kanë një taksë të fiksuar prej 10%, ose fillojnë përqindjen e taksës progresive prej 10%.

Tatimi i Vlerës së Shtuar nuk ndryshon shumë në të gjitha vendet. Nga perspektiva e investitorëve potencialë, TVSH-ja nuk është aq e rëndësishme nëse produktet e prodhuara janë të destinuara për tregjet e eksportit, dhe në këtë rast ato lirohen nga TVSH-ja. Mirëpo, ky tatim ndikon në koston e inputeve. Kosova ka përqindjen më të ulët të TVSH-së në Ballkanin Perëndimor dhe BE27. TVSH-ja në Kosovë është 16% krahasuar me 20% në Shqipëri dhe Serbi ose 25 në Kroaci. Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina krahasohen ngjashëm me Kosovën, me një përqindje të TVSH-së prej 17%, dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM) me 18%.

Sidoqoftë, është me rëndësi të theksohet se shumica e vendeve aplikojnë përqindje të zvogëluar ose të shkallës së dytë të TVSH-së për produkte të caktuara me interes strategjik ose social. Vetëm Kosova, Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina nuk aplikojnë përqindje të këtyre të TVSH-së. Një aspekt tjetër në të cilin Kosova dallon për sa i përket aplikimit të TVSH-së është mbledhja e tij në kufi nga Dogana e Kosovës dhe pjesërisht nga Administrata Tatimore e Kosovës. Arsyeet pse kjo paraqet një problem për firmat do të diskutohen në kapitujt vijues.

Tabela 2. Tabelë krahasuese e përqindjes së taksave për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE27

			Tatimi i Vlerës së Shtuar (VAT)		
			Përqindja		Qarkullimi minimal vjetor për regjistrim të detyrueshëm
	Tatimi mbi të ardhurat e korporatave	Tatimi mbi të ardhurat personale	E plotë	E zvogëluar	
Shqipëri	<8,000,000 = 15%	0-30,000 = 0%			
(ALL)	8,000,000-2,000,000 = 7.5%	30,000-130,000 = 13%	20%		5,000,000
	>2,000,000 = 25,000 të fiksuar	<130000 = 23%			
Bosnja e Hercegovina (BAM)	10%	10%	17%		50,000
	>100,000 në vjet në Republika Srpska = 2%				
Kroacia (HRK)	20%	12%-40% varësisht nga shkalla e të ardhurave	25%	10%	230,000
FYROM (MKD)	10%	10%	18%	5%	2,000,000
Mali i Zi (EUR)	9%	0-720 = 9%	17%	7%	18,000
		<720 = 15%			
Serbia (RSD)	15%	10%	20%	10%	8,000,000
Kosova (EUR)	10%	0-80 = 0%	16%		50,000
		80-250=4%			
		250-450=8%			
		<450=10%			
BU27 (EUR)	22.75% ¹⁸	37.82% ¹⁹	21% ²⁰	9%	29,535 ²¹

Burimi: Deloitte. Pikat kryesore ndërkombëtare të tatimeve 2014; KPMG. Tabela e tatimit mbi të ardhurat e korporatave; Eurostat. VAT Gap.

18 <http://www.kpmg.com/global/en/services/tax/tax-tools-and-resources/pages/corporate-tax-rates-table.aspx>

19 Ibid.

20 http://ec.europa.eu/taxation_customs/resources/documents/common/publications/studies/vat-gap.pdf

21 <http://www.vatlive.com/eu-vat-rules/vat-registration-threshold/>

Pasqyra krahasuese sugjeron se përqindja e taksave në Kosovë nuk ka mundur të jetë pengesë serioze zhvillimore për katër sektorët e prodhimit dhe se ato në përgjithësi kanë qenë më të favorshme se në vende të tjera, duke krijuar kështu, së paku nga perspektiva tatimore, një përparësi ndaj konkurrentëve nga partnerët kryesorë tregtarë. Ky argument është mbështetur me të dhëna nga indekset e tjera krahasuese, si ato të Bankës Botërore “Raporti i të bërit biznes”. Raporti i radhit vendet në bazë të treguesve të shumtë, një nga të cilët është “Pagesa e tatimeve”. Kosova është në vendin 43 globalisht në këtë tregues. Tabela krahasuese më poshtë ilustron se Kosova ka përqindje shumë më të ulët të taksës (si përqindje e fitimit) – në 15.4% - në krahasim me Evropën dhe Azinë Qendrore (38.7%) dhe vendet OECD (41.3%).

Tabela 3: Renditja e Kosovës në bazë të treguesit të “Pagesës së tatimeve” sipas “Raportit të të bërit biznes”

Treguesi	Kosova	Evropa dhe Azia Qendrore	OECD
PAGESA E TATIMEVE	43* (radhitje globale)		
Pagesat (numër në vjet)	33	26	12
Koha (orë në vjet)	162	246	175
Tatimi i fitimit (%)	9.1	9.0	16.1
Tatimi dhe kontributet e forcës punëtore (%)	5.6	22.6	23.1
Tatime të tjera (%)	0.7	7.0	2.0
Përqindja e përgjithshme e taksave (% e fitimit)	15.4	38.7	41.3

Burimi: “Raporti i të bërit biznes 2014.” (Banka Botërore)

Një mënyrë tjetër për të vlerësuar barrën e taksave në Kosovë është që ajo të shihet në një perspektivë relative në krahasim me faktorë të tjerë në mjedisin e biznesit. “Raporti i të bërit biznes” thekson se pagesa e tatimeve, në terme relative, është një nga problemet më të vogla për bizneset e Kosovës. Problemet më të mëdha, me të cilat përballen firmat janë efikasiteti i institucioneve, sidomos i gjyqësorit – domethënë, zbatimi i kontratave (138), marrja me lejet e ndërtimit (136) dhe tregtia jashtë kufijve (121).

Tablela 4: Radhitja globale e Kosovës në “Raportin e të bërit biznes”

Treguesi	Renditja
Zbatimi i kontratave	138
Marrja me lejet e ndërtimit	136
Tregtia jashtë kufijve	121
Energjia elektrike	121
Fillimi i biznesit	100
Mbrojtja e investitorëve	98
Zgjidhja e falimentimit	83
Regjistrimi i pronës	58
Pagesa e tatimeve	43
Sigurimi i kredisë	28


Burimi: “Raporti i të bërit biznes 2014.” (Banka Botërore)

Tjetër mënyrë e vlerësimit të barrës tatimore do të ishte të shihen të dhënat e mbledhjes së taksave nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe të kontrollohet nëse sjellja e firmave në lidhje me pagesat e taksave ka reaguar ndaj ndryshimeve në përqindjet tatimore. Siç do të demonstron edhe në pjesët e ardhshme të këtij raporti, ekziston një shkallë e lartë e joformalitetit në Kosovë. Nëse përqindjet e taksave do të ishin problem për prodhuesit e Kosovës gjatë dekadës së fundit, atëherë do të ishte e arsyeshme të supozojmë se zbritja e konsiderueshme e përqindjes – si për shembull zvogëlimi i përqindjes për **tatimin mbi të ardhurat e korporatave** dhe përqindjes maksimale të **tatimit mbi të ardhurat personale** nga 20% në 10% në vitin 2009 – do të kishte shkaktuar rritje të numrit të firmave të prodhimit që vendosin të formalizojnë dhe të raportojnë të ardhurat në ATK.

Të dhënat nga ATK (Figurat 7 dhe 8) në fakt tregojnë se nuk ka ndodhur asgjë e tillë. Numri i firmave që regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) u rrit me një ritëm të vazhdueshëm dhe nuk tregoi asnjë rritje të rëndësishme në vitin 2009 ose 2010, gjë që do të ishte në përputhje me vendimin e firmave të mëparshme joformale për t’u regjistruar pas ndryshimit të politikave. Regjistrimi i firmës së re duket të ketë reaguar më shumë ndaj cikleve të biznesit të përgjithshëm në krahasim me ndryshimin e përqindjes së taksave. Fakti që ndryshimet e përqindjeve tatimore nuk kanë modifikuar sjelljen e firmave të prodhimit, për sa i përket raportimit të të hyrave, është konfirmuar edhe nga intervistat me firmat e kontabilitetit, të cilat shërbejnë prodhuesit si klientë.²²


22 Intervistë me një firmë kontabiliteti që punon për disa firma të prodhimit.

Figura 7: Numri i firmave që i raportojnë ATK



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, 2014.


Figura 8: Ndryshimi vjetor i numrit të firmave që i raportojnë ATK



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, 2014

Edhe pse të dhënat e prezantuara deri më tani kanë ofruar dëshmi se përqindjet e taksave në Kosovë janë përgjithësisht të ulëta, dhe si të tilla mund të mos kenë ndikuar negativisht në sektorët e prodhimit, këtë mendim nuk e ndajnë firmat. Të dhënat nga sondazhet me katër sektorët e prodhimit tregojnë se ekziston një tendencë e fuqishme që ato të konsiderojnë përqindjet e taksave në Kosovë të larta ose shumë të larta, gjë që nënkupton të kundërtën e asaj që është argumentuar deri më tani – që në fakt, taksat kanë pasur ndikim pengues në zhvillimin e sektorëve. Siç është ilustruar në Figurën 9 më poshtë, vetëm 7-10% e firmave në katër sektorët e prodhimit i konsiderojnë përqindjet e taksave shumë të ulëta ose të ulëta, kurse të tjerët i konsiderojnë ato si mesatare (35-47%), të larta (33-41%) ose shumë të larta (12-16%).

Figura 9: Si do të përshkruanit përqindjet e taksave në Kosovë?



Burimi: Sondazh i UNDP 2013

Duhet theksuar se perceptimi i përqindjes së taksave varet nga konteksti dhe mjedisi i biznesit, madje edhe nga karakteristikat e përgjithshme kulturore të vendit. Në këtë drejtim, perceptimi se taksat janë të larta, mund të jetë rezultat i shkallës së lartë të izolimit, informimit të gabueshëm dhe mungesës së vetëdijes që mund të kenë bizneset e Kosovës lidhur me taksat në vendet e tjera, përfshirë këtu edhe vendet fqinje. Përveç kësaj, mund të përfshihet edhe elementi kulturor, pasi që disa kultura kanë predispozitë më të lartë për të qenë të zëshëm në shprehjen e pakënaqësisë së tyre, sidomos në sondazhe ku sigurohet anonimiteti. Nëse të dhënat nga Figura 1 merren si shembull – ai që ilustron pakënaqësinë me përqindjet e taksave në vende të ndryshme në mbarë botën – informatat e pasakta dhe faktorët kulturorë mund të jenë pjesë e shpjegimit se pse disa vende me përqindje të ngjashme të taksave kanë shkallë të ndryshme të pakënaqësisë.

Megjithatë, ekzistojnë prova sipas të cilave një nga arsyet më të rëndësishme pse firmat prodhuese në Kosovë i konsiderojnë taksat të larta, është për shkak se shumica e tyre funksionojnë me flukse të kufizuara të parave dhe të shitjes – në fakt janë në prag të falimentimit. Edhe nëse përqindjet e taksave mund të konsiderohen si normale apo të ulëta – siç kuptohet nga të dhënat krahasuese – firmat i konsiderojnë si të larta, sepse ato marrin nga margjinat e kufizuara të fitimit ose nga fondet e parashikuara për investime të rëndësishme ose pagesë të kredive të mëdha. Prandaj, përgjigjet e sondazhit mund të ndikohen nga një shkallë e atribuimit të papërshtatshëm të fajit. Faktorë të tjerë në mjedisin e biznesit krijojnë barriera dhe kosto të mëdha – për shembull përqindjet e kamatave, kohët e fundit 11% për kreditë afatgjata të investimit²³ - kështu që çdo shkallë e taksave duket e lartë ose e rëndë.

Argumenti se taksat konsiderohen të larta për shkak të problemeve të falimentimit mbështetet edhe më shumë me faktin se një numër i madh i firmave nuk raportojnë të gjitha aktivitetet e veta ose vendosin të veprojnë në mënyrë joformale. Një raport i Institutit Riinvest vlerëson se përqindja e joformalitetit në sektorin privat është 34% kurse për firmat prodhuese edhe më e lartë²⁴. Profilet e Sektorëve të përpiluar nga UNDP në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe

²³ Banka Qendrore e Kosovës

²⁴ Institutit Riinvest. "Të pagosh a mos pagosh" http://www.fes-prishtina.org/ëb/media/Publications/2013/BUSINESS_INFORMATIONALITY__ENG_FINAL.pdf


Industrië gjithashtu konsiderojnë se firmat në mënyrë drastike fshehin shitjet ose të dhënat e prodhimit në përgjigjet e tyre për pyetjet e sondazheve. Në disa raste si në sektorin e përpunimit të metaleve, vlera e inputeve të përgjithshme të raportuara nga sektori ishte pothuajse dyfish më e madhe se vlera e rezultateve të raportuara²⁵.

Praktika e mosraportimit të plotë të shitjeve dhe shtrirja e saj e gjerë u konfirmua nga intervistat me përfaqësues të firmave të kontabilitetit që veprojnë në Kosovë dhe të cilat kanë prodhuesit si klientë²⁶. Shembujt individualë nuk mund të përfaqësojnë modelet e plota, mirëpo disa mund të jenë në gjendje të kapin dhe të ilustronë trendet e përgjithshme për atë se pse firmat zgjedhin të funksionojnë në mënyrë joformale (përveç për arsyen e kuptueshme “për shkak se munden”, ose për shkak të zbatimit të dobët nga ATK, që do të diskutohet në pjesën tjetër). Një konsulent profesional, i cili aktualisht punon për një prodhues të madh në zhvillimin e projektit të ri dhe me qasje në të dhënat financiare, mendonte se nëse kompania do të raportonte flukset e të gjitha të ardhurave, “nuk do të ishte në gjendje të mbijetojë”²⁷. Në këtë aspekt, joformaliteti mund të konsiderohet se ka një ndikim pozitiv, pasi që krijon hapësirë frymëmarrjeje për kompanitë e sapoformuara dhe të brishta, duke u dhënë atyre kohë për t’u përmirësuar dhe për t’u bërë më konkurrues. Efektet negative të joformalitetit janë trajtuar në pjesën tjetër.

5.2 Vlerësimi i ndikimit të administratës tatimore

Të dhënat nga sondazhet me katër sektorët e prodhimit sugjerojnë se firmat që operojnë në të katër sektorët kanë përgjithësisht perceptime të ngjashme mbi efikasitetin e dy institucioneve kryesore përgjegjëse për administrimin e tatimeve të mbledhura në Kosovë - Dogana e Kosovës (DK) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Siç ilustron në Figurat 10 dhe 11 më poshtë, pjesa më e madhe e firmave deklarojnë se kanë nivel mesatar të kënaqësisë me dy institucionet. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i firmave janë të pakënaqura. Pakënaqësia është vetëm pak më e lartë me Doganën e Kosovës në krahasim me Administratën Tatimore të Kosovës.

Figura 10: Si do ta përshkruanit më së miri efektshmërinë e Doganës së Kosovës?




25 Profil i sektorit për përpunimin e metalit

26 Intervistë me biznese.

27 Intervistë me konsulent.

Figura 11: Si do ta përshkruanit më së miri efektshmërinë e Administratës Tatimore të Kosovës?




Burimi: Sondazh i UNDP 2013

Intervista me përfaqësues të bizneseve ka nxjerrë në pah dy probleme kryesore me administrimin e sistemit tatimor dhe doganor në Kosovë, të cilat duket se përfaqësojnë pengesa më të mëdha për funksionimin e biznesit të tyre se sa përqindjet ekzistuese tatimore apo doganore. Këto pengesa janë: a) mbledhja e TVSH-së nga ana e Doganës së Kosovës në pikën kufitare, para përdorimit të produkteve si inpute ose para se të shiten, dhe b) shkalla e lartë e joformalitetit, e cila krijon një mjedis të favorshëm për konkurrencë të padrejtë apo ndëshkime arbitrare dhe selektive nga inspektorët e ATK-së.

Mbledhja e TVSH-së në kufi ka rritur koston e të bërit biznes: Deri më tani, mbledhja e TVSH-së në kufi është ankesa numër një që është identifikuar gjatë intervistave me përfaqësues të sektorit apo me firmat e kontabilitetit / revizionit që punojnë për një numër të madh të prodhuesve. Siç ilustron Figura 12, në vitin 2013, Dogana e Kosovës ka mbledhur 411 milionë euro në emër të tatimit të TVSH-së në kufi, ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës ka mbledhur 113 milionë euro brenda vendit. Perceptimi i përgjithshëm është se kjo është një mënyrë më efektive që institucionet e Kosovës të gjenerojnë të ardhura, pasi që është më e lehtë për Doganën e Kosovës që mallrat të regjistrohen në kufi sesa për ATK-në të inspektojë ose të ndjekë shitjet brenda Kosovës. Në një aspekt kjo pasqyron dështim të institucioneve për të krijuar sistem të besueshëm të kontrollit dhe raportimit brenda Kosovës.

Përmes TVSH të mbledhur në kufi, Dogana e Kosovës është në gjendje të mbledhë rreth ¼ e buxhetit të Kosovës, mirëpo këtë e bën në kurriz të bizneseve, duke rritur koston e të bërit biznes.

Figura 12: Mbledhja e TVSH nga Dogana dhe ATK



Burimi: Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës

Intervistat me përfaqësues të biznesit kanë nxjerrë në pah se mbledhja e TVSH-së në pikat kufitare krijon probleme të mëdha likuiditeti për firmat, pasi që ato duhet të paguajnë një sasi të madhe të parave të gatshme paraprakisht, madje para se t'i kenë përdorur mallrat që kanë blerë për funksionimin e biznesit të tyre. Kjo është veçanërisht problematike duke pasur parasysh faktin se shumica e firmave nuk qëndrojnë mirë me para të gatshme dhe funksionojnë në prag të falimentimit dhe/ose aftësisë paguese. Është veçanërisht problematike për firmat e reja, që në thelb krijohet një pengesë e madhe hyrjeje, duke dëmtuar kështu edhe konkurrencën. Paguesa e TVSH-së në kufi bllokton një sasi të madhe të kapitalit që do t'u lejonte firmave të investojnë ose të punësojnë më shumë punëtorë.


Joformaliteti ka krijuar bazë për masat anti-konkurrese dhe arbitrare nga organet tatimore: Problemi i dytë më i madh me administrimin e sistemit tatimor që është theksuar gjatë intervistave, dhe i cili është konfirmuar edhe nga burime të tjera, ishte joformaliteti dhe shmangia e taksave, gjë që krijon hapësirë për masa arbitrare nga inspektorët e taksave dhe në këtë mënyrë për praktika anti-konkurrese. Perceptimi i përgjithshëm është se administratorët e taksave janë të vetëdijshëm se shumica e firmave nuk raportojnë aktivitetin e tyre të plotë. Kjo krijon hapësirë për keqpërdorim, meqenëse bizneset më të fuqishme dhe me lidhje më të mira mund të përdorin inspektorët tatimorë për të shkaktuar dëme mbi konkurrentët, duke e ditur se ata janë të pambrojtur. Në sondazhin e realizuar nga Instituti Riinvest lidhur me joformalitetin, në shkallën prej 1 deri në 10, bizneset dhanë rezultatin prej 4.6 për pyetjen nëse inspektorët

tatimorë mund të korruptohen apo të keqpërdorin autoritetin e tyre, gjë që nënkupton se mund të ketë raste të konsiderueshme të abuzimit të tillë²⁸.

Disa shembuj që janë përmendur gjatë intervistave me bizneset, mund të ilustrojnë natyrën e problemeve me të cilat përballen ata që konsiderojnë ATK joefikase ose jashtëzakonisht joefikase. Një firmë e intervistuar kontabiliteti ka treguar shembullin e dy bizneseve fqinje dhe konkurruese, ku një nga ato ka funksionuar në joformalitet të plotë kurse tjetri ka paguar disa taksa përkundër raportimit të mangët të shitjes. Në mënyrë ironike, këtë të fundit e kanë vizituar inspektorët tatimorë dhe është detyruar të mbyllet për shkak të gjobave.²⁹ Fakti që konkurrenca joformale është pengesë e madhe për bizneset është vërtetuar pothuajse nga të gjitha sondazhet e biznesit që janë realizuar në Kosovë gjatë viteve të fundit.³⁰

Joformaliteti kryesisht ndodh për shkak të zbatimit të dobët nga ana e ATK: Joformaliteti ekziston jo vetëm për shkak se shumë firma stimulohen për t'u përfshirë në të, por edhe për shkak se institucionet e mbledhjes së taksave nuk janë efikase në mbledhjen e tyre. Të dhënat reale nga ATK nuk ilustrojnë vetëm shkallën e lartë të joformalitetit në katër sektorët e prodhimit që janë subjekt i këtij studimi, por edhe shkallën e lartë të përgjegjësisë për zbatimin më të mirë. Për shembull, grafiku në figurën 13 që ilustron tendencën e mbledhjes së taksave për tre lloje të tatimeve (tatimit të korporatave, tatimit mbi të ardhurat personale dhe TVSH) për firmat që veprojnë në katër sektorët e prodhimit. Është e qartë nga grafikët se përfshirja e pajisjeve fiskale në vitin 2009 nga institucionet e Kosovës, në mënyrë dramatike ka rritur mbledhjen e TVSH-së, tatim i cili tregon se sa shitje nuk janë raportuar dhe se sa ndikim mund të ketë zbatimi më i mirë i zvogëlimit të joformalitetit.

Figura 13: Përpunimi i metalit



28 Instituti Riinvest. "Të pagosh a mos pagosh" http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2013/BUSINESS_INFORMATIONALITY__ENG_FINAL.pdf

29 Intervistë me bizneset.

30 Shih për shembull Raportin e UNDP për Zhvillimin Njerëzor 2012 ("Sektori privat dhe punësimi") ose profilet e sektorëve të përpiluara nga UNDP-MTI.

Figura 14: Tekstili




Figura 15: Përpunimi i drurit





Figura 16: Përpunimi bujqësor




Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, 2014.

6. PËRKUFIZIM I PROBLEMIT: ILUSTRIM GRAFIK

Të dhënat empirike të paraqitura në pjesët e mëparshme lënë të kuptohet se katër sektorët e prodhimit janë zhvilluar gjatë dekadës së fundit, mirëpo nuk ekziston asnjë mënyrë për të matur ndikimin e drejtpërdrejtë të regjimit të taksave, qoftë pozitiv apo negativ. Megjithatë, nuk ka asnjë provë bindëse që nënkupton se përqindjet tatimore kanë pasur efekt negativ, ndërsa faktorët që kanë të bëjnë me administratën tatimore, kanë pasur një ndikim të përzier. Një shkallë e lartë e joformalitetit që është mundësuar nga zbatimi i dobët i mbledhjes së taksave, në fakt u ka mundësuar firmave hapësirë të rëndësishme për zhvillim. Por gjithashtu shkaktoi edhe disa probleme që rritën koston tashmë të lartë të të bërit biznes – duke përfshirë këtu, dëmtimin e konkurrencës në mes dhe përbrenda sektorëve, pasi që jo të gjitha firmat u shmangen taksave në të njëjtën masë. Struktura e problemit është paraqitur në formën e një druri problematik në Figurën 14.

Figura 17: Ilustrim grafik, druri problematik.



7. KONKLUZË: IMPLIKIMET POLITIKE

Në këtë dokument u shfrytëzuan të gjitha të dhënat empirike që ishin në dispozicion për të vlerësuar ndikimin e regjimit tatimor në zhvillimin e katër sektorëve të prodhimit në Kosovë: metalit, drurit, tekstilit dhe përpunimit të ushqimit. Këta katër sektorë janë zhvilluar gjatë dekadës së fundit edhe pse kanë filluar nga një bazë shumë e ulët. Megjithatë, ende ballafaqohen me shumë kufizime dhe pengesa të cilat kanë rritur koston e të bërit biznes dhe kështu kanë zvogëluar konkurrencën e tyre në tregjet gjithnjë e më të integruara rajonale dhe globale. Në përgjithësi, konkluza që mund të nxirret nga të dhënat është se në aspekt relativ, faktorët që kanë të bëjnë me tatimin nuk janë përcaktuesi kryesor për zvogëlimin e aftësisë konkurruese të prodhuesve kosovarë. Problemet kryesore shtrihen diku tjetër dhe kanë të bëjnë me koston e financimit, koston dhe cilësinë e forcës së punës, etj. Megjithatë, ekzistojnë disa çështje të rëndësishme që identifikohen në këtë hulumtim, të cilat duhet të theksohen dhe të cilat mund të trajtohen nga perspektiva e përqindjes dhe administrimit të taksave për të mbështetur zgjerimin e këtyre katër sektorëve të prodhimit. Në vija të përgjithshme, dy implikimet kryesore të politikave që dalin në pah janë:

a) Përqindjet e taksave nuk janë të larta por mund të zvogëlohen edhe më shumë ose madje edhe të hiqen tërësisht me heqjen e përkohshme të taksave

Provat tregojnë se përqindjet e taksave në Kosovë janë të ulëta në krahasim me vendet e tjera në rajon apo edhe në Evropë. Por shumica e prodhuesve kosovarë ende i konsiderojnë të larta,

kryesisht për shkak se ata veprojnë në një mjedis ku kostoja e të bërit biznes është tashmë e lartë. Prandaj, ata drejtohen në joformalitet, i cili, në mesin e efekteve të tjera negative siç janë mundësitë më të ulëta për të marrë kredi, gjithashtu i bën ata të pambrojtur ndaj arbitraritetit dhe shantazheve të zyrtarëve tatimorë, krijon kushte që favorizojnë konkurrencën e padrejtë, dhe më tej rrisin koston e tyre të të bërit biznes.

Një zgjidhje e mundshme për këtë problem mund të jetë zvogëlimi i përqindjes së taksave³¹ në minimum ose edhe heqja e përkohshme e taksave për firmat e sektorit, duke i eliminuar pagesat e taksave plotësisht për një periudhë të caktuar (p.sh. pesë ose shtatë vjet), njëkohësisht duke marrë masa shtesë për të siguruar që ato megjithatë do të regjistrohen në ATK dhe do të raportojnë të ardhurat e tyre, gjë që do t'i zyrtarizonte ato në afat më të gjatë. Një mundësi tjetër do të ishte të formohen paketa stimuluese për procesin e filluar të krijimit të zonave të lira ekonomike, të cilat do të krijojnë kushte për grupim sektorial.

Sigurisht që kohëzgjatja optimale e heqjes së përkohshme të taksave, fushëveprimi i përfituesve dhe kriteret e tyre duhet të hulumtohen më hollësisht si pjesë e studimeve të ardhshme – meqë shtrirja e këtij studimi është e kufizuar. Por ajo që mund të thuhet me besim për katër sektorët që janë pjesë e këtij studimi është se masa të tilla mund të shpiejnë drejt disa zhvillimeve pozitive. Më e rëndësishmja është se kjo do t'u jepte firmave hapësirë të mjaftueshme për të trajtuar pengesat e tjera në mjedisin e tyre të biznesit dhe t'u mundësonte të formalizojnë dhe kështu të reduktojnë rrezikun nga çfarëdo veprimi arbitrar dhe anti-konkurrues të inspektorëve tatimorë.

Gjithashtu, ekziston arsye për të besuar se një masë e tillë mund të jetë e mundur nga pikëpamja fiskale, në qoftë se aplikohet vetëm për këta sektorë. Vlera e përgjithshme e taksave të mbledhura nga të katër sektorët ka përfaqësuar një pjesë shumë të vogël në arkën e të hyrave të mbledhura nga ATK. Siç ilustron Figura 15, nga të katër sektorët në vitin 2013 janë mbledhur vetëm rreth 11 milion euro taksa (personale, të biznesit ose të korporatës). Figura 16 tregon se të hyrat nga këta katër sektorë të prodhimit përfaqësojnë vetëm një pjesë të të ardhurave të përgjithshme që ATK-ja i merr nga taksat mbi të ardhurat e korporatave, të ardhurat personale, taksa e biznesit dhe TVSH-ja. Për shembull, në vitin 2013, ndërsa tatimet e mbledhura nga të katër sektorët ishin 11 milionë euro, shuma e përgjithshme e këtyre taksave të mbledhura në Kosovë ishte 231 milionë euro.

Taksat e këtyre sektorëve përfaqësojnë vetëm 4.4% nga taksat e përgjithshme që i mbledh Administrata Tatimore e Kosovës. Ndoshta do të ishte e arsyeshme të supozohet se pjesa e TVSH-së që i pagohet Doganës së Kosovës përmes mbledhjes në kufi nga sektori prodhues është e njëjtë me atë që i pagohet ATK-së. Nëse gjeneralizohet nga shuma e përgjithshme e TVSH të mbledhur nga Dogana e Kosovës (410 milionë euro), shuma prej 4.4% do të përfshinte pagesën e taksave prej rreth 16.5 milionë euro, duke përgjithësuar shumën e taksave për këta katër sektorë të prodhimit (me përjashtim të detyrimeve doganore) në rreth 28 milionë euro në vjet. Kjo është vetëm një pjesë e të ardhurave të përgjithshme në buxhetin e Kosovës prej rreth 1.5 miliardë euro.

31 Qëllimi i këtij dokumenti nuk është të rekomandojë për kë do të zbatohen uljet e taksave – respektivisht, nëse kjo do të bëhet vetëm për katër sektorët, për të gjitha firmat e prodhimit apo për të gjitha bizneset. Ky thjesht tregon se një ulje e tillë do të përfshinte katër sektorët.

Figura 18: Mbledhja e përgjithshme e taksave për të katër sektorët, sipas llojit të taksës





Figura 19: Mbledhja e përgjithshme e taksave për të katër sektorët, sipas llojit të taksës



b) Është jashtëzakonisht me rëndësi të forcohen kapacitetet e ATK për mbledhjen e taksave

Ekzistimi i një shkalle të lartë të joformalitetit sugjeron se kapacitetet e Administratës Tatimore të Kosovës për mbledhjen e taksave janë të dobëta. Prandaj buxheti i Kosovës mbështetet në Doganën e Kosovës për mbledhjen e TVSH-së në kufi, pasi që është më lehtë të konfiskohen mallrat në kufi se sa pasi të kenë hyrë në Kosovë. Mirëpo, mbledhja e TVSH-së në kufi bllokton kapitalin e vlefshëm nga bizneset që përballen me kufizime të falimentimit dhe funksionojnë në një mjedis ku kostoja e të bërit biznes është tashmë e lartë. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë që Doganës së Kosovës t'i caktohet vetëm roli i regjistrimit të hyrjes së mallrave, gjë që do t'i mundësojë Administratës Tatimore të Kosovës të krahasojë importin e raportuar me deklaratat financiare të firmave dhe të mbledhë TVSH-në pas shitjes. Për këtë mund të jetë i nevojshëm krijimi i një softveri të përbashkët për këmbim të informatave mes ATK dhe Doganës. Administrimi më i mirë i sistemit tatimor mund të jetë vendimtar për të shmangur abuzimet në rast të stimujve të veçantë (si për shembull uljet e veçanta tatimore) ose për të parandaluar masat anti-konkurruese dhe arbitrare të taksa mbledhësve ndaj firmave të veçanta.

BIBLIOGRAFIA

Firmë e Kontabilitetit dhe Revizionit 1. (2014, prill). (A. Maliqi dhe D. Pozhegu, Intervistues)

Firmë e Kontabilitetit dhe Revizionit 2. (2014, prill). (D. Pozhegu, Intervistues)

Firmë e Kontabilitetit dhe Revizionit 3. (2014, prill). (A. Maliqi, Intervistues)

Alija, E. K. (2014). Profili i Sektorit të Përpunimit të Ushqimit dhe Industrisë së Paketimit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Deichmann, J. I. (2012). Trashëgimia Historike dhe Investimet e Huaja Direkte në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Estrin, S., & Uvalic, M. (2013). Investimet e huaja direkte në ekonomitë në tranzicion: a është Ballkani ndryshe?

Komisioni Evropian (DG TAXUD). (2013, korrik). *Studim që përcakton sasinë dhe analizon zbraztirën e TVSH në Shtetet Anëtare të BE-27.*

Firmë e Përpunimit të Ushqimit me seli në Prishtinë. (2014, maj). (A. Maliqi, dhe D. Pozhegu, Intervistues)

Gashi, A. (2014). Profili i Sektorit për Industrinë e Përpunimit të Drurit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

James, S. (2009). Stimujt dhe investimet tatimore dhe jotatimore: Dëshmi dhe Iplikime Politike. Dhjetor.

Kersan-Skabic, I., & Edvard Orlic. (2007). Përcaktuesit e fluksit të IHD në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe vendet e Ballkanit Perëndimor (A është anëtarësimi në BE më rëndësi për joshjen e IHD?).

Qeveria e Kosovës. (2014). Vendimi Nr. 02/178.

Qeveria e Kosovës. (2014). Vendimi Nr. 03/178.

Qeveria e Kosovës. (2014). Vendimi Nr. 07/186.

KPMG. (2014). *KPMG*. Marrë në gusht 2014, nga www.kpmg.com:

<http://www.kpmg.com/global/en/services/tax/tax-tools-and-resources/pages/corporate-tax-rates-table.aspx>

Maliqi, A. (2014). Profili i Sektorit për Industrinë e Përpunimit të Metalit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Mateev, M., & Tsekov, I. (2012). A posedojnë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore përparësi IHD në krahasim me vendet më të zhvilluara perëndimore?

- Firmë e Përpunimit të Metalit me seli në Prishtinë. (2014, prill). (A. Maliqi, Intervistues)
- Qefalia, A., & Rexhepi, P. (2009). Situata Aktuale dhe Perspektivat e Investimeve të Huaja Direkte në rajonin e Ballkanit.
- Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë,, F. (2014, maj). (D. Pozhegu dhe A. Maliqi, Intervistues)
- Përfaqësues i Ministrisë së Financave. (2014, maj). (D. Pozhegu, & A. Maliqi, Intervistues)
- Instituti Riinvest. (2014). *Të pagosh a mos pagosh*.
- Rizvanolli, A. (2014). Profili i Sektorit të Industrisë të Tekstilit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
- Rojec, M., & Penev, S. (2011). Atraktiviteti i vendeve të Ballkanit Perëndimor për IHD.
- Serin, V., & Çaliskan, A. (2010). Politikat e Liberalizimit Ekonomik dhe Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore.
- Sokoli, Y., Zaho, L., & Sokoli, I. (2011). Klima e Biznesit si një nga përcaktuesit kryesorë të Investimeve të Huaja Direkte në Jug.
- Sykianakis, N. (2007). Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rrezikut në IHD: Studim hulumtues në Ballkan.
- Firmë e tekstilit me seli në Gjakovë. (2014, maj). (D. Pozhegu, Intervistues)
- The Economist. (2014, May 05). *The Economist*. Marrë në gusht 2014, nga [www.economist.com: http://www.economist.com/blogs/graphicdetail/2014/05/daily-chart-1?src=scn%2Ftë%2Fte%2Fdc%2Ftaxedandtired](http://www.economist.com/blogs/graphicdetail/2014/05/daily-chart-1?src=scn%2Ftë%2Fte%2Fdc%2Ftaxedandtired)
- UNDP. (2012). *Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2012*.
- UNMIK. (1999). Regullore Nr. 1999/16: Për themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera të lidhura me të.
- UNMIK. (1999). Regullore Nr. 1999/3: Për themelimin e Doganës dhe të shërbimeve të tjera përkatëse në Kosovë.
- UNMIK. (2001). Regullore Nr. 2001/11: Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.
- UNMIK. (2002). Regullore Nr. 2002/4: Për Tatimin mbi të Ardhurat personale.
- UNMIK. (2004). Regullore Nr. 2004/51: Për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave.
- VATlive. (2014). *VATlive*. Marrë në gusht 2014, nga [www.vatlive.com: http://www.vatlive.com/eu-vat-rules/vat-registration-threshold/](http://www.vatlive.com/eu-vat-rules/vat-registration-threshold/)
- Banka Botërore. (2014). *Të bërit Biznes 2014*.



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND



*Empowered lives.
Resilient nations.*

